



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shpenzime për aktivitete Social-Kulturore dhe sportive të vitit "**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): ): shërbime administrative rekreative, kulturore dhe fetare :75124000-1, shërbime rekreative, kulturore dhe sportive :92 , shërbime çlodhjeje , kulturore dhe sportive:91000000-1 ,**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2 685 200 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind )lekë pa tvsh**

**Argumentimi i fondit limit:**Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim", çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer nëpërmjet tre ofertave., komisioni ka vendosur cmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.1933/2prot,datë 19.03.2024 .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit (E HAPUR E THJESHTUAR) është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenin 49 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”; si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin11, pika 1, gërma b dhe neni 55,i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*1. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*2. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST-së.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”; si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.i ndryshuar

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*a.Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per

prokurimin publik"; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik për të përbushur me sukses kontratën.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

### **2.2.1**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht: 1000 000 lekë pa tvsh.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik";, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: "**Shpenzime për aktivitete Social-Kulturore dhe sportive të vitit** " pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 500 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;; dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri

kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër levrimitin e shërbimeve të sipas grafikut të levrimit të shërbimeve bashkëngjitur preventivit shtojca 6 e DST-së.**

**Argumentimi:** Me anë të kësaj deklarate synohet OE do të jete i gatshëm të kryejë realizimin e shërbimeve sipas grafikut të levrimit në kohë dhe pa problematika, gjatë zbatimit të kontratës

**2.3.3-** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së*” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik” si dhe përcaktimet e pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

U ra dakort nga antaret e Njesisë se Prokurimit te ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor, **nr.31, datë.26.03.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **"Shpenzime për aktivitete Social-Kulturore dhe sportive të vitit "**, me fond limit prej: **2 685 200 (dy milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind )lekë pa tvsh, lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

\*\*\*

**SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:***Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes, bashkëngjitur DST ne SPE. Specifikimi i Materialeve:*

1. **Këngëtarë** Në kuadër të festave lokale "Festa e serave të gjelbërta" një këngëtar. ``24 Korriku ``tre këngëtar, në muajin Korrik , ``Festa e Ullirit ``një (këngëtar)në muajin Tetor dhe ``Njeriu i Vitit ``dy , në muajin dhjetor.
2. **Animator**  
Në kuadër të festës së 1 qershorit animatorët do të realizojnë festën e fëmijëve.
3. **Vajza Myzeqare**  
Materiali Bronz , bashkëngjitur do të gjeni foto të modelit .
4. **Qytetar Nderi**

Qytetar Nderi sipas modelit të fotos bashkëlidhur

**5. Ftesa për të ftuarit**

Materiali karton dhe te specifikuara sipas festave ``24 Korrikut `` në muajin Korrik , ``Festa e Ullirit ``në muajin Tetor dhe ``Njeriu i Vitit ``në muajin dhjetor dhe dizanj.

**6. Certifikata mirënjohje**

Material kartoni në formatin A4, dizenjim dhe printim sipas kërkesës përpara organizimit të aktivitetit për ndarje të certifikatave

**7. Kuti dhe shishe për vaj ulliri**

Kuti material druri që të shërbejë për vendosjen e shishes e cila do të ketë vaj ulliri. Në kapakun e kutisë të jetë shkruar bashkia Roskovec dhe Logo e bashkisë. Shishe vaj ulliri, Material qelq , me etikë me logon e Bashkisë Roskovec si edhe me tapë . Në masën 750 ml .

**8. Canta rrobe**

Canta material rrobë 25 cm e gjerë dhe 30 cm e gjatë , ngjyrë bezhë dhe me logon e bashkisë.

**9. Kupa 24 Korriku**

Në kuadër të festës së 24 Korrikut , organizohet edhe kupa 24 Korriku për skuadrën fituese material inoks

**10. Medalje**

Medalje për fituesit e kupës 24 Korrik dhe medalje për Naftëtarët

**11. Sapunë**

Sapunë organik të prodhuar me mbetjen e ullirit si dhe me veshje të plotë dhe me etiketë ku të jetë shkruajtur dhe se me çfare arome është sapuni i prodhuar

**12. Kulinarizëm**

Vlersim për personat që do të angazhohen për gatimet tradicionale, vlera duhet te jete e pandryshuar.

**13. Juria e Vlerësimit**

Shpërblim për jurin e vlersimit për 10 titujt për aktivitetin “Njeriun e Vitit” Vlera është e pandryshuar.

**14. Vlerësim për fituesit**

Vlersimi për fituesit e aktivitetit 24 Korrik , Vlersim për fituesit e vajit të ullirit , Shpërblim për fituesit (sporti) në kuadër të “Festës së Ullirit”, Cmimet për fituesit e konkursit me shkollat 9 vjecare Maj 2024. Vlera është e pandryshuar.

**15. Skena**

Skena do të përdoret për aktivitetet e ``24 Korriku ``.Skena duhet të jetë standarte dhe duhet të ketë ndricim të përfshirë dhe foninë.

**16. Kokteil**

Kokteli duhet të ketë të përfshirë ushqime, ëmbëlsira dhe pije. Koteli do të organizohet sipas kërkesës paraparake për cdo aktivitet

**17. Dekor zbukurues për muzeun**



Për dekor duhet të ketë hark me tullumbace me ngjyrë gold dhe të zezë . Shirit Dekorues Ngjyrë të kuqe. Dekori do të realizohet sipas kërkesës paraprake nga drejtoria përkatëse.

**18. Media**

Media do të realizojë regjistrim dhe do të prodhonj lajm të shkruar dhe të regjistruar sipas kërkesës paraprake të drejtorisë përkatëse

**19. Vjolinist**

Do të jetë pjesë e aktivitetit sipas kërkesës paraprake të drejtorisë përkatëse

**20. Fletpalosje**

Fletëpalosje ne format A4 , leter 170 gr, me 1 ose disa palosje. Dizanj dhe printim

**21. Tapet i kuq**

Tapet i kuq me permasa 3m me 4m për evenimente

**22. Ekran Led**

Ekran led me përmasa 5 m me 3m, sipas kerkeses paraprake për përdorim në aktivitete

**23. Banderol**

Banderol me përmasa 5 m me 3 m. Dizenjim dhe printim sipas kerkeses paraprake nga drejtoria perkatese

**24. Dekor festues per femije**

Dekor zbukurues per festen e 1 qershorit.

**25. Cirk**

Për realizimin e aktivitetit per 1 qershorin festen e fëmijëve

**26. Portret Kryetar Keshilli ndër vite**

Printim foto dhe vendosje në kornizë druri ngjyrë kafe, përmasat 70 m me 50 m

**27. Albitra**

Albitrat do të jenë pjesëmarrës në ndeshjet që do të realizohen sipas grafikut të realizuar nga drejtoria përkatëse

**28. Degustues vaj ulliri**

Gjatë aktivitetit të festës së ullirit do të realizohet degustimi i vajit të ullirit nga ekspert të fushës.

**29. Dhurata për të ftuarit**

Për cdo të ftuar që do të jenë pjesë e aktivitetit do të dhurohen simbole të bashkise sipas modeleve ne fotot bashkëlidhur

**30. Medalie “Njeriu i Vitit”**

Dizenjim dhe prodhim medalje për 10 titujt “Njeriu I Vitit”. Sipasa kërkesës paraprake nga drejtoria përkatëse.

**31. Komisionerët**

Komisionerët do të realizojnë vlersimet për 10 titujt e nderit në kuadër të festës “Njeriu i Vitit”

**32. Shpërblim për grupet e punës**

Grupet e punës që do të realizojnë konkurset për shkollat 9 vjecare.

**33. Juria Vlersuese**



Juria do të jetë e dedikuar për vlersimin e nxënësve në kuadër të konkurseve që do të realizohen gjatë vitit.

*Argumentim:* Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm :KLLFLST( Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.1933prot,datë 12.03.2024,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë.:**Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushes konkretishtë nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik si specifikimet teknike te mallrave dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. nr.1933prot,datë 12.03.2024dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave/sherbimeve.**

**Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin: "Shpenzime për aktivitete Social-Kulturore dhe sportive të vitit "**

**Shërbimet që kërkohen:**

**"Dita e Veres"**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Animator	persona	2
2	Embëlsira	copë	100
<b>SHUMA 1</b>			

**Dita e inagurimit të Muzeut**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Kokteil	persona	50
2	Dekor zbukurues për Muzeun	copë	2
3	Media	copë	2
4	Vjolinist	persona	2
5	Fletpalosje	copë	100
6	Tapet I kuq	copë	2

**Festa lokale Marinëz  
/Inagurimi I Bustit**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Ekran Led	copë	1
2	Medalje për naftëtarët	copë	10
3	Media	copë	2
4	Kokteili	persona	70

**Festa e serave të gjelbërta**

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Banderol	copë	1
2	Këngëtar	persona	1
4	Koktejl	persona	20

### 1 Qershori

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Animator	persona	2
2	Dekor festues për fëmijët	copë	1
3	Cirk	persona	5

### Festa e 24 Korrikut

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Këngëtar	persona	3
2	Ftesa për te ftuarit	persona	50
3	Skulpturë Vajza Myzeqare	copë	30
4	Medalje Qytetar Nderi	persona	20
5	Portret Kryetarë e Këshillit ne vite	persona	30
6	Certifikata mirënjohje	copë	20
7	Kupa 24 Korriku material inoks	copë	1
8	Medalje për fituesit e aktiviteteve	copë	15
9	Sapun artizanal të roskovecit	copë	60
10	Vlersim për fituesit	persona	5
11	Foni	copë	1
12	Albitra	persona	3
13	Koktejl	persona	50
14	Canta rrobe për dhurata	copë	30

### "Festa Ullirit"

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>
1	Skulpturë Vajza Myzeqare	copë	10
2	Kuti druri dhe Shishe vaj ulliri	copë	30
3	Canta rrobe për dhurata	copë	30
4	Vlersim për fituesit të vaj ullirit	copë	2
5	Degustues vaj ulliri	persona	2
6	Këngëtar	persona	1

7	Kokteil	persona	80
8	Shpërblim për fituesit (sporti)	persona	3

### "Njeriu I Vitit"

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Ftesa për të ftuarit	persona	50
2	kokteil	persona	55
3	Këngëtar, instrumentist	persona	2
4	Dhurata për të ftuarit	copë	20
5	Medalie "Njeriu I Vitit"	persona	15
6	Komisionerët	persona	30

### Konkurse me shkollat 9- vjecare dhe të mesme

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Cmimie për fituesit	persona	50
2	Certifikata për nxënësit më të mirë	copë	50
3	Shpërblime për grupet e punës	persona	29
4	Juria vlerësuese	persona	20
			<b>Totali pa TVSH</b>
			<b>TVSH</b>
			<b>Totali</b>

**Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës mbaron deri më 31.12.2024 ,sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor në përputhje me grafikun e të lëvrimit të shërbimeve.**

Grafik i levrimit te sherbimeve

Objekti: Shpenzimet per Aktiviteteve Sociale Kulturore dhe sportive te vitit

Sherbimet	Pershkrimi	Shuma	Vendi i Ekzekutimit	Afati e Ekzekutimit
Kokteil Dekor zbukurues për Muzeun Media Vjolinist Fletpalosje Tapet I kuq	Dita e inagurimit të Muzeut	190 000 All	Roskovec	01Maj 2024- 23 Maj2024
Ekran Led	Festa lokale	254 000 All	Roskovec	01Maj 2024- 23

Medalje për naftëtarët Media Kokteili	Marinëz /Inagurimi I Bustit			Maj2024
Banderol Këngëtar Kokteil	Festa e serave të gjelbërta	114 000 All	Roskovec	01 Maj 2024-25 Maj 2024
Animator Dekor festues për fëmijët Cirk Animator Embëlsira	1 Qershori	80 000 All	Roskovec	25 Maj 2024-01 Qershor 2024
Këngëtar Ftesa për te ftuarit Skulpturë Vajza Myzeqare Medalje Qytetar Nderi Portret Kryetarë e Këshillit ne vite Certifikata mirënjohje Kupa 24 Korriku material inoks Medalje për fituesit e aktiviteteve Sapun artizanal të roskovecit Vlersim për fituesit Foni Albitra Kokteil Canta rrobe për dhurata	Festa e 24 Korrikut	829 700 All	Roskovec	01 Korrik 2024 - 24 Korrik 2024
Skulpturë Vajza Myzeqare Kuti druri dhe Shishe vaj ulliri Canta rrobe për dhurata Vlersim për fituesit të vaj ullirit Degustues vaj ulliri Këngëtar Kokteil	"Festa Ullirit"	370 000 All	Roskovec	01 Tetor 2024 – 27 Tetor 2024

Shpërblim për fituesit (sporti)				
Ftesa për të ftuarit kokteil Këngëtar, instrumentist Dhurata për të ftuarit Medalie "Njeriu I Vitit" Komisionerët	"Njeriu I Vitit"	490 500 All	Roskovec	01 Dhjetor 2024 – 17 Dhjetor 2024
Cmimie për fituesit Certifikata për nxënësit më të mirë Shpërblime për grupet e punës Juria vlerësuese	Konkurse me shkollat 9- vjecare dhe të mesme	350 000 All	Roskovec	Nentor –Dhjetor 2024

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**